

Data 24.10.2025

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE  
PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

OBJEKTI I PROCEDURËS: **“BLERJE UJË I PIJSHËM”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Ujë mineral 15981000-8; Ujë mineral pa gaz 15981100-9; Ujë natyral 41100000-0; Ujë i pijshëm 41110000-3;

VLERA E FONDIT LIMIT: **2,583,300** (dy milion e pesëqind e tetëdhjetë e tre mijë e treqind) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Tiranë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

**Argumentimi:** Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorezimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të

pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar.

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të objektit që prokurohet**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar; nenin 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar ku përcaktohet se: "Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata". Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c ku përcaktohet se: "Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit "Shërbim konsulence". Në nenin 55 pika 4 të VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar është përcaktuar se: "Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohej në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave".

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës "Procedurë e hapur të thjeshtuar" edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi referuar dispozitave ligjore si më sipërcituar.

**2.2.2.** Kopje të certifikuara të bilanceve të viteve (2022,2023, 2024) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021

*“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.*

**2.2.3.** Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia ose Komuna në të cilën është regjistruar sipas QKB-se.

Shënim: \*\*\* Kriteri 2.2.3 konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr 9. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

**Argumentimi:**Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore sipas kësteve pranë bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’ju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1**Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më të vogël se 20% e vlerës së fondit limit të objektit që prokurohet**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës ose/dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.

- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenit 55, pika 4(b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit limit. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 55 pika 4 gërma (b) e VKM nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) duke qënë se vlera e fondit limit është nën kufirin e ulët monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit, të të gjithë artikujve të kërkuar në adresën e autoritetit kontraktor. Ofertuesi duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim se:

- a) Do të ofrojë shërbim të garantuar brenda orarit zyrtar për furnizimin periodik me ujë.
- b) Do të ofrojë këtë shërbim duke siguruar furnizim me ujë të së njëjtës linjë prodhimi (markë) gjatë gjithë periudhës në bidona 19 litërsh.
- c) Do të ofrojë këtë shërbim duke siguruar aparate uji me mekanizëm ftohës dhe ngrohës.

**Argumenti:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që vërtetojnë dhe zotërojnë kapacitetet teknike dhe profesionale për përmbushjen e detyrimeve kontraktore. Ky shërbim do të ofrohet përgjatë 12 muajve nga nënshkrimi i kontratës, sa here që AK do të ketë nevojë. Deklarimi me shkrim nga OE për realizimin e të gjitha specifikimeve teknike dhe shërbimit objekt prokurimi shërben si angazhim paraprak që garanton seriozitetin e ofertës dhe përgatitjen për përmbushjen e kontratës në përputhje me kërkesat teknike të përcaktuara në DST.

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të paraqesë fletë analizën fiziko-kimike dhe mikrobiologjike të ujit brenda normave të lejuara, si dhe analizën fiziko-kimike dhe mikrobiologjike të ujit të burimit, lëshuar nga autoriteti përkatës. (Analizat duhet të jenë lëshuar gjatë muajit të fundit).

**Argumenti:** Kjo kërkesë është vendosur bazuar në nenin 40, pika 6, gërma c) e VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 për miratimin e rregullave të prokurimit publik i ndryshuar, sipas përcaktimit si vijon:

Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

- a) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucionet e autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën e konformitetit të ambalazhit (bidona 19 litërsh), lëshuar nga prodhuesi dhe certifikatën e konformitetit për aparatin (dispenser) lëshuar nga prodhuesi.

**Argumenti:** *Certifikata e konformitetit, ose ndryshe certifikata e cilësisë, përdoret për certifikimin e mallrave të prodhuara, punëve dhe shërbimeve. Certifikata e marrë është dëshmi e konformitetit të një produkti të caktuar me aktet rregullatore aktuale. Ato mallra që mund të ndikojnë në jetën dhe sigurinë e njerëzve i nënshtrohen certifikimit të detyrueshëm. Certifikata, e cila lëshohet për kontratë, kërkon domosdoshmërisht praninë e një faze testimi për konformitetin e produkteve me standardet dhe kërkesat, dhe pas kësaj, rezultatet e testeve laboratorike të kryera futen detyrimisht në certifikatën e marrë, e cila duhet të përmbajë informacione se kush lëshon dhe kush e merr këtë certificate. Certifikata e konformitetit shtë një dokument që vërteton pajtueshmërinë e një objekti me kërkesat e rregulloreve teknike, dispozitat e standardeve ose kushtet e kontratave.*

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë se disponon aparat shpërndarës për përdorim gjatë periudhës së furnizimit, të pajisur me 3 (tre) rubineta uji me sistem ngrohës, ftohës dhe ambienti, si dhe të jetë i pajisur me frigorifer, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9.

**Argumentimi:** *Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.*

*Referuar specifikimeve teknike dhe kërkesave të percaktuara nga Autoriteti Kontraktor për realizimin e këtij objekti prokurimi, lind e nevojshme edhe disponimi i pajisjeve dhe aparaturave teknike të kërkuara.*

**2.3.6** Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikata të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, të jetë në përputhje me objektin e prokurimit, të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës si më poshtë:

- ISO 9001:2015 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” (e vlefshme) ose ekuivalent;
- ISO 14001:2015 “Mbi Sistemet e menaxhimit të mjedisit” (e vlefshme) ose ekuivalent;
- ISO 22000:2005 “Mbi sistemin e menaxhimit të Sigurisë Ushqimore” (e vlefshme) ose ekuivalent;

**Argumentimi:** *Kriteret për paraqitjen e ISO-ve sa më sipërcituar u vendosën në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ne baze të Njoftimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.2502 Prot., date 09.04.2021, si dhe ligjit nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku percaktohet se këto Certifikata duhet të jenë lëshuar nga organizma certifikues të*

akredituar, me qëllim që enti prokurues të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur me aftësinë e tyre për te realizuar kontratën. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë certifikimet e nevojshme të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për realizimin e objektit të kontratës.

Kerkesa për certifikime sipas standardeve ISO janë në vetvete një garanci me teper për suksesin e projektit, në lidhje me cilësinë e produktit.

- **Certifikatë ISO 9001:2015 (ose e përditësuar, për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë)**

Përmbushja e standartit ISO 9001 është thelbësore, dhe siguron menaxhimin e cilësisë së shërbimeve që kategorizohen në kontratë. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standarteve të cilësisë. ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë dhe mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga Operatori Ekonomik, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit, planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit/shërbimit, sigurimin e konformitetit për shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

- **Certifikatë ISO 14001:2015 “Mbi Sistemet e menaxhimit të mjedisit”**

ISO 14001 specifikon kërkesat e përgjithshme për vendosjen e një sistemi të menaxhimit mjedisor në një kompani. Ai përqendrohet në njohjen e të gjitha aspekteve mjedisore dhe menaxhimin efektiv të pasojave të aktivitetit të një kompanie duke e mundur atë për të përmirësuar ndikimin e performancës së përgjithshme mjedisore të kompanisë. Një organizatë mund të marrë dhe zbatojë certifikimin ISO 14001, pavarësisht nga madhësia ose qëllimi i saj. Sistemet e menaxhimit të mjedisit bazuar në ISO 14001 ofrojnë mundësinë për të identifikuar, vlerësuar dhe menaxhuar aspektet mjedisore të një organizate me qëllim:

- Parandalimit të dëmtimit të mjedisit;
- Vlerësimin të aspekteve mjedisore;
- Përmirësimin e performancës mjedisore;
- Respektimin e ligjeve;
- Ruajtjen e burimeve natyrore dhe uljen e kostos;
- Përmirësimin e imazhit të kompanisë;
- Përmirësimin e komunikimit me figurat e autoritetit.

- **Certifikatë ISO 22000:2018 ekuivalente/të barazvlefshme, certifikatë e sistemit të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore**

Standarti ISO 22000 është standardi më i lartë i certifikimit të Sistemeve të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore. Parimet themelore të standardit janë:

- Kontroll efektiv në të gjithë zinxhirin e furnizimit ushqimor;
- Komunikim efektiv midis të gjitha palëve të interesuara të zinxhirit të furnizimit ushqimor (biznese, furnitorë, klientë, autoritete);

- Menaxhim sistematik;
- Programet e nevojshme;
- Parimet e analizës së rrezikut dhe pikat kritike të kontrollit (HACCP);

*Standardi bazohet gjithashtu në parimet që janë të përbashkëta me standardet e sistemit të menaxhimit. Parimet e menaxhimit janë:*

- Fokus ndaj klientit;
- Angazhimi i menaxhimit të lartë;
- Pjesëmarrje aktive e personelit;
- Qasje ndaj procesit;
- Përmirësim i vazhdueshëm;
- Vendimmarrje e bazuar në dokumentacion;
- Menaxhim i marrëdhënieve me palët e interesuara;

### **Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë**

*Kërkesa për ISO 9001, ISO 14001, ISO 22000, janë kërkesa të domosdoshme për të garantuar realizimin me sukses të kontratës.*

**2.3.7** Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë 2 (dy) automjete për transporti me kapacitete mbajtës të paktën 3.5 ton për transportin e mallit të cilat duhet t'i ketë në pronësi/me qira/mbështetje nga një operator ekonomik, për të cilën duhet të paraqes dokumentacionin e mëposhtëm:

- Në rastet kur mjeti është në pronësi: Certifikatë pronësie; dokument që vërteton regjistrimin e mjetit; Leje Qarkullimi; siguracionin e vlefshëm të mjetit (policën e sigurimit); certifikatën e vlefshme të kontrollit teknik (SGS).
- Në rastet kur mjeti është me qera: Kontratë Qeraje noteriale për gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi; Certifikatë pronësie; dokument që vërteton regjistrimin e mjetit; Leje Qarkullimi; siguracionin e vlefshëm të mjetit (policën e sigurimit); certifikatën e vlefshme të kontrollit teknik (SGS).

**Shënim:** Kriteri Nr.2.3.7 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 9. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit;

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, të pika 4/ç të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Nëpërmjet këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomik të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

**2.3.8** Operatori ekonomik duhet të provojë se disponon të paktën 1 (një) stabiliment prodhimi dhe të paktën 1 (një) ambient magazinimi me sipërfaqe minimale 30m<sup>2</sup> me qëllim prodhimin

dhe magazinimin e mallit objekt prokurim, për të cilën duhet të paraqes dokumentacion që vërteton pronësinë/ qiramarrjen si më poshtë:

➤ *Dokumentacion që vërteton pronësinë:*

- Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj; ose
- kontrata e shitblerjes; ose
- kontrata e dhurimit; ose
- çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

➤ *Dokumentacion që vërteton marrjen me qira:*

- Kontratë qiraje (e vlefshme)

**Shënim:** Kriteri Nr.2.3.8 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 9. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit;

**Argumentimi:** Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

### **Specifikimet teknike**

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

### **Specifikimet teknike**

Përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve është grupi i punës i ngritur pranë Autoritetit Kontraktor përfitues Bashkia Tiranë për objektin që prokurohet, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Specifikimet teknike të produktit që është objekt prokurimi janë si më poshtë vijon;

**Specifikimet teknike janë pjesë përbërëse e e dokumentave standarte të tenderit, për procedurën me objekt: “Blerje ujë i pijshëm” si më poshtë:**

Përbërësit fiziko-kimik të ujit të mos jenë më të larta se:

- CA 16 mg/l;
- Mg 4 mg/l;
- SO<sub>4</sub> 9 mg/l;
- Ph 8 mg/l;
- TDS 70 mg/l;
- Fortësia 3 mg/l.

**Shënim:** *Për çdo certifikatë, standart, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës të përmendur më lart, pranohet edhe ekuivalenti i tyre.*

Sa më sipër, kërkesat për kualifikim, janë hartuar nga njësia e prokurimit konform kritereve dhe specifikimeve teknike hartuar nga grupi I punës ngritur pranë Autoritetit Kontraktor. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

**Bashkëlidhur këtij procesverbali:**

- Dokumentat e tenderit
- Specifikimet teknike

**Bashkëlidhur këtij procesverbali:**

*Dokumentat e tenderit*